

358
15.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë.

E-mail: klsb.org.al; web-site www.klsb.org.al

Nr. 2415 Prot.

Tiranë, më 13.4.2021

Lënda: Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, në auditimin e fundit në Këshilli Qarkut Gjirokastrë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 43, datë 12.04.2021.

Drejtuar: Znj. Lindita ROVA
KËSHILLI QARKUT

GJIROKASTËR

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka përfunduar në institucionin që Ju drejtoni, auditimin me objekt: "Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.01.2020 deri 30.06.2020", të realizuar mbi bazën e programit të auditimit nr. 241, prot., datë 10.02.2021.

Në zbatim të neneve 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe Manualin "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve", miratuar me Vendim nr. 67, datë 23.06.2020, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka hartuar Raportin Përfundimtar të Auditimit të zbatimit rekomandimeve bashkëlidhur kësaj shkrese.

Nga auditimi ka rezultuar:

I. Mbi hartimin e Plan veprimit dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit 20 ditor dhe raportimi me shkrim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor nga dhënia e rekomandimeve.

KLSH-ja ka dërguar në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 1047/5 prot, datë 22.04.2020. Këshilli i Qarkut Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 89/12 Prot, datë 15.05.2020 ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve. Në lidhje me zbatimin e afatit 6 mujor nga momenti i dërgimit të shkresës për zbatimin e rekomandimeve, nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 670 Prot, datë 26.10.2020.

II. Mbi pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

- Janë rekomanduar gjithsej **10 masa organizative** me vlerë 12,649,256 lekë, pranuar në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar **8 masa**, është në proces gjyqësor **1 (një)** masë me vlerë 5,231,856 lekë ose 41%. Nuk është zbatuar **1 (një)** masa me vlerë 7,417,400 lekë ose 59%, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Këshilli Qarkut Gjirokastrë.

- Janë rekomanduar gjithsej **1 (një) masë disiplinore**, e cila është pranuar dhe zbatuar nga Këshilli Qarkut Gjirokastrë.

- Janë rekomanduar gjithsej **3 masa administrative**, me vlerë **120,000 lekë**. Ky rekomandim klasifikohet i zbatuar, pasi për një person është arkëtuar vlera prej 40,000 lekë dhe për 2 persona me vlerë 80,000 lekë, në proces ankimi në gjykatë.

Për sa sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit", Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me **Vendimin nr. 43, datë 12.04.2021**, ka vendosur **ripërsëritjen** e tyre, duke **rikërkuar** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve (*Trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bashkëlidhur kësaj shkrese*).

A. MASA ORGANIZATIVE

Janë rekomanduar gjithsej 10 masa organizative me vlerë 12,649,256 lekë, pranuar në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar 8 masa. Është në proces gjyqësor 1 (një) masë me vlerë 5,231,856 lekë. Nuk është zbatuar 1 (një) masë me vlerë 7,417,400 lekë, për të cilat rikërkojmë edhe njëherë zbatimin e tyre si më poshtë:

1- Gjetje nga auditimi (sipas pikës 5 të masave organizative): Nga auditimi i të ardhurave dytësore që realizon Këshilli i Qarkut bazuar në legjislacionin në fuqi, u konstatua se ka një sasi të konsiderueshme të ardhura të pa arkëtuara nga bashkitë, në formën e kuotave të anëtarësisë, të cilat janë miratuar nga këshillat e tyre përkatëse në vlerën **7,417,400 lekë**, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

Konkretisht, detyrimet janë: Bashkia Gjirokastrë për 3,000,000 lekë; Bashkia Libohovë për 828,400 lekë; Bashkia Dropull për 153,000 lekë; Bashkia Tepelenë për 815,000 lekë; Bashkia Memaliaj për 1,168,000 lekë; Bashkia Përmet për 600,000 lekë dhe Bashkia Këlcyrë për vlerën 900,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën III faqe 24-25, të Raportit të Auditimit, dhe aneks III*).

1.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, të marrë masa për të mbledhur kuotat nga bashkitë përbërëse të qarkut, duke përdorur të gjitha mënyrat e mundshme, përfshirë edhe procedurat gjyqësore.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi (sipas pikës 12 të masave organizative): Nga auditimi i ri kërkimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në janar 2018, është ri kërkuar shpërblimi i dëmit në shumën **5,231,856 vlerën lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera prej 5,231,856 lekë është arkëtuar vlera prej 125,667 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej 5,106,349 leke, e cila është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 – "Debitorë të Pasqyrave Financiare" më datën 31.12.2016.

Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit deri më datën 15.01.2020, janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë, janë kontabilizuar dhe janë arkëtuar në 8 raste vlera

125,667 lekë; Nuk janë pranuar, nuk janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe nuk janë kontabilizuar vlera 199,500 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 17 -18, të Raportit të Auditimit, dhe aneks I).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, të merren masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij. Të njoftohet KLSH për masat e marra.

Menjëherë

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces sipas rezultateve të këtij auditimi, kërkojmë dhe inkurajojmë përsheptimin e plan veprimit për realizimin e plotë të tyre brenda **20 ditëve** nga marrja e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi bashkëlidhur kësaj shkrese.

Pavarësisht auditimit që ne kemi kryer për zbatimin e rekomandimeve, ju kujtojmë që në mbështetje të nenit 30, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **jeni të detyruar që brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës**, duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve tona, si dhe ju bëjmë me dije se zbatimi i rekomandimeve do të jetë pjesë e auditimit të radhës nga KLSH, në subjektin Tuaj.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

K R Y E T A R

Arben SHEHU





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimit e ushtruar në Këshillin e Qarkut
Gjirokastrë: *“Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në
auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2020 deri 30.06.2020”.*

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK

**“MBI AUDITIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E
MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.01.2020 DERI 30.06.2020”, NË KËSHILLIN E
QARKUT GJIROKASTËR.**

Tiranë, Prill 2021

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	3 - 4
	I/1. Hyrje.....	
	I/2. Objektivat e auditimit.....	
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	
	I/4. Metodologjia auditimit.....	
	I/5. Konkluzioni.....	
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	5 - 5
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar nga 01.07.2017 - 31.12.2019.....	5 - 16
	<i>III/1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”</i>	5 - 5
	<i>III/2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.</i>	5 - 5
	III/3. Realizimi i rekomandimeve.....	5 - 15
	A. Masa organizative.....	5 - 13
	B. Masa disiplinore.....	13 - 13
	C. Masa administrative.....	13 - 15
IV	Konkluzione dhe rekomandime.....	15 - 16
V	ANEKSE.....	16 - 19

I. PËRMBLEDHJE:

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim në **Këshillin e Qarkut Gjirokastrë** mbi: "Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në periudhën 01.01.2020 – 30.06.2020", paraqitur me shkresën nr. nr. 1047/5 datë 22.04.2020 (*prot subjekt nr. 89/10 datë 27.04.2020*), duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{se}, të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2020;
- Hartimi i programeve (*plan veprimeve*) nga subjekti i audituar, me personat përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si; vendimeve (*urdhrave*) për zbatimin e masave organizative, vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit, vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore;
- Vendimet për marrjen e masave administrative nga organet vendimmarrëse të përcaktuara me ligj, si APP që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH^{ja} me shkresën nr. 1047/5 datë 22.04.2020, ka dërguar në Këshilli Qarkut Gjirokastrë rekomandimet e auditimit. Këshilli Qarkut Gjirokastrë për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 89/12 *Prot*, datë 15.05.2020 ose brenda 20 ditësh, në zbatim të shkronjës (j) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Në lidhje me zbatimin e afatit 6 mujor nga momenti i dërgimit të shkresës për zbatimin e rekomandimeve për përmisimin e gjendjes, nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 670 *Prot*, datë 26.10.2020, në zbatim të pikës 2 e nenit 30-*Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Këshilli Qarkut Gjirokastrë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve sipas Vendimin nr. 8, datë 14.05.2020 të Këshillit Qarkut Gjirokastrë "Për miratimin e Plan-Programit në zbatim të rekomandimeve të KLSH", duke ngarkuar personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete (*Plan pune hartuar nga Titullari i Institucioni mbi zbatimin e rekomandimeve, nr. 296/2 datë 15.05.2020*).

Sipas llojet paraqiten si më poshtë vijon:

- **10 masa organizative** me vlerë 12,649,256 lekë, pranuar në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar **8 masa**, është në proces gjyqësor **1 (një)** masë me vlerë 5,231,856 lekë ose 41%. Nuk është zbatuar **1 (një)** masa me vlerë **7,417,400 lekë** ose 59%, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Këshilli Qarkut Gjirokastrë.

- **1 (një) masë disiplinore**, e cila është pranuar dhe zbatuar nga Këshilli Qarkut Gjirokastrë.

- **3 masa administrative**, me vlerë **120,000 lekë**. Ky rekomandim klasifikohet i zbatuar, pasi për një person është arkëtuar vlera prej 40,000 lekë dhe për 2 persona me vlerë 80,000 lekë, në proces ankimi në gjykatë.

I/1. HYRJA:

Auditimi është kryer në zbatim të Programit të Auditimit nr. 241 *Prot*, datë 10.02.2021 dhe autorizimin nr. 241/4 *Prot*, datë 11.02.2021, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe Manualin "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të

rekomandimeve”, miratuar me Vendim nr. 67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, i përbërë:

1. Kristaq Gjurgjaj (Përgjegjës grupi)

2. Berti Meçaj anëtar

I/2. Objekti auditimit: Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit paraqitur me shkresën nr. 1047/5, datë 22.04.2020, ky auditim ka si objekt, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së titullarëve të institucioneve publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmtshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

I/3. Qëllimi auditimit: Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në lidhje me zbatimin i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresat nr. 1047/5 datë 22.04.2020, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

I/4. Metodologjia e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësisë dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësive në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni: Nga auditimi në terren i dokumentacionit dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të paraqitura nga subjekti Këshilli Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 197/3, datë 26.03.2021 (*prot KLSH nr. 241/35, datë 29.03.2021*), në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 1017/7, datë 22.04.2020, rezulton se nga gjithsej **14** masa (*organizative, 3-E, mungesë të ardhurash, disiplinore dhe administrative*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi **13** masa ose 92.8% dhe nuk është zbatuar akoma **1 (një)** masë ose 7.1%.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 92.8 %, tregon se nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër është vlerësuar maksimalisht procesi i zbatimit të rekomandimeve, por duhet të përqendrohet akoma më shumë në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara dhe të proceseve gjyqësore, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve :

Puna e bërë nga Këshilli Qarkut Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është vlerësuar maksimalisht, gjë e cila shihet dhe nga niveli i lartë e realizimit në masën 92.8%. Kjo tregon se si procesi i auditimit dhe rekomandimet e lëna nga KLSH-ja, kanë qenë efektive dhe masa të cilat kanë ndikuar në përmisimin e punës në të ardhmen e institucioni.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2019.

III/1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

KLSH-ja ka dërguar në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë shkresën nr. 1047/5 datë 22.04.2020, mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit kryer për periudhën objekt auditimi 01.01.2016 - 31.12.2019. Këshilli Qarkut Gjirokastrë për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 89/12 Prot. datë 15.05.2020, ose brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, nga Këshilli Qarkut Gjirokastrë është miratuar plani i veprimeve sipas Vendimin nr. 8, datë 14.05.2020 të Këshillit Qarkut Gjirokastrë “Për miratimin e Plan-Programit në zbatim të rekomandimeve të KLSH”, duke ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete (Plan pune hartuar nga Titullari i Institucioni mbi zbatimin e rekomandimeve, nr. 296/2 datë 15.05.2020).

Statusi: Zbatuar

III/2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Këshilli Qarkut Gjirokastrë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1047/5 datë 22.04.2020, për të cilën subjekti duhet që brenda 6 muajve të raportonte në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të tyre ose brenda datës 22.10.2020.

Me shkresën nr. 670 Prot, datë 26.10.2020, KQ Gjirokastrë ka informuar KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për periudhën e auditimit 01.01.2016 - 31.12.2019. Pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, në zbatim të pikës 2 e nenit 30- Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Statusi: Zbatuar

III/3- Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Janë rekomanduar gjithsej 10 masa organizative me vlerë 12,649,256 lekë, pranuar në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar 8 masa, është në proces gjyqësor 1 (një) masë me vlerë 5,231,856 lekë dhe nuk është zbatuar 1 (një) masë me vlerë 7,417,400 lekë, si më poshtë vijon:

1- Gjetje nga auditimi: Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, grupi i auditimit testoi disa nga komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm, nga të cilat rezultoi; nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur në 2 nga 5 komponentët e tij, e konkretisht në mjedisin e kontrollit dhe në aktivitetet e kontrollit, sa vijon:

- ✓ Nuk ka manuale mbi procedurat për operacionet kryesore. Këshilli i Qarkut Gjirokastrë nuk ka mekanizma të cilat t’i dedikohen ankesave për korrupsion;
- ✓ Vetë Këshilli i Qarkut Gjirokastrë nuk ka plan trajnimesh, por është pjesë e trajnimeve të organizuara nga institucionet qendrore në fushat e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, planifikimit strategjik, të menaxhimit të burimeve njerëzore etj.;
- ✓ Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të Teknologjisë së Informacionit.
- ✓ Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, për shkak të numrit të vogël në strukturën organizative, nuk ka Audit të brendshëm. Ai auditohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit një here në 3 -4 vjet. Nga ana e këtij Institucioni nuk janë marrë masa sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 43 “Kontrolli i jashtëm dhe auditimi”, pika 4, ku përcaktohet se: “4. *Me vendim të veçantë të këshillit bashkiak ose të këshillit të qarkut, organet ekzekutive të njëjsteve të vetëqeverisjes vendore mund t’i nënshtrohen auditimit të kryer nga shoqëri të specializuara në fushën e auditimit*” (Më hollësisht trajtuar në pikën II faqe 18-19, të Raportit të Auditimit, dhe aneks II).

1.1 Rekomandimi:

Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë të analizojë shkaqet e mos funksionimit të mjedisit të kontrollit dhe aktivitetit të kontrollit, të nxirren përgjegjësitë dhe të merren masa për:

- Për hartimin e manualeve mbi procedurat për operacionet kryesore;
- Vendosjen e një sistemi të mirëfillte unik i mbajtjes së kontabilitetit.
- Hartimin e mekanizmave të cilat t’i dedikohen ankesave për korrupsion.
- Hartimit të një plani trajnimesh dhe kryerjes së trajnimeve.
- Vendosjen e rregullave që të garantojnë sigurinë e sistemit Teknologjisë së Informacionit.

Nga auditimi konstatohet se:

Me shkresën nr. 338/3 datë 24.06.2020 është hartuar “Manuali Operacionale” për procedurat kryesore.

Në lidhje me rekomandimin për vendosjen e një sistemi të mirëfillte unik të mbajtjes së kontabilitetit, nuk është kompetencat tona, pasi është projekt i Ministrisë së Financave sipas së cilit gjithë institucionet e administratës shtetërore do adoptojnë sistemin unik të kontabilitetit dhe raportimit në thesar sipas një kalendari të caktuar. Hapi parë i këtij procesi fillon me arkivën elektronike të shpenzimeve në të cilën institucioni ynë është planifikuar të fillojë në shtator të këtij viti.

Përsa i takon mekanizmave të dedikuara ndaj ankesave për antikorrupsion në ambientet e KQGJ, në një pozicion të mirë ekspozuar është vendosur Kutia e ankesave në përputhje me standarde që parashikojnë dispozitat ligjore përkatëse. Ndërsa në lidhje me ankesat të ardhura në “Platformën e bashkëqeverisjes”, ato kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore.

Me shkresën nr. 243/1 datë 10.03.2020 është hartuar “Kalendari i trajnimeve të brendshme” dhe janë kryer trajnime në afatet e parashikuara, me përjashtim të trajnimeve të planifikuara në periudhën Mars-Qershor 2020, të cilat janë shtyrë për arsye të situatës së krijuar prej gjendjes së emergjencës së shkaktuar nga COVID- 19. Sipas dokumentacionit i gjithë stafi është i trajnuar dhe brenda vetë institucioni dhe ASPA.

Statusi: Zbatuar

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se **13** vendime gjyqësore për largime nga puna, të cilat janë kontabilizuar, kanë dhënë efekt financiar negativ në buxhetin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë në shumën **13,776,860** lekë. Institucioni ka kërkuar pakësimin e tyre nëpërmjet rrugëve

gjyqësore dhe duke mos u pajtuar me vendimet e gjykatave për detyrimet që lindin nga largimet nga puna, po ezaurojnë të gjitha shkallët gjyqësore, deri në Gjykatën e Lartë për anulimin e këtyre vendimeve (10 vendime janë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, nga të cilat janë pranuar pezullimet vetëm për 3 raste dhe janë të gjitha në pritje për shqyrtim). Për rastet kur ka pasur punësime të ish-punonjësve në administratën shtetërore, institucioni i është drejtuar gjykatës me padi për pavlefshmëri të titujve ekzekutive (5 raste). Ekzekutimi i detyrimeve (në rastet kur vendimet janë rikthim në punë) nëpërmjet kthimit në punë në institucion në momentin kur është krijuar vend i ri ose vakant (ka pasur dy vendime të tilla, të cilat janë ekzekutuar) *(Më hollësisht trajtuar në pikën III faqe 19 - 21, të Raportit të Auditimit, dhe aneks III)*.

2.1 Rekomandimi:

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të nxjerrë përgjegjësitë ligjore e administrative ndaj personave shkaktarë të cilët kanë krijuar detyrimin prej **13,776,860 lekë** për **13** vendime gjyqësore, çfarë ka ndikuar negativisht në buxhetin e shtetit, si dhe të marrë masa për planifikimin e fondeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë të marrë masa në rastet e largimeve nga puna të punonjësve të zbatohen të gjitha procedurat e duhura ligjore me qëllim që të shmangen efektet financiare në buxhet nga zhvillimi i proceseve gjyqësore.

Nga auditimi konstatohet se:

Vendime gjyqësore për largime nga puna që i takojnë periudhës 2007-2012, ku dhe efektet financiare që rrjedhin nga këto vendime kanë shkaktuar një kosto të lartë në buxhetin e Këshillit të Qarkut (13,776,860 lekë). Në mbledhjen e datës 31.01.2020 i është kërkuar Këshillit marrjen e pasave karshi personave përgjegjës, por nga kjo e fundit është refuzuar një vendim për marrjen e masave ndaje shkaktarëve.

- Në lidhje me Vendimet Gjyqësore që i takojnë periudhës 2015, ato janë si shkak i ristrukturimit të institucionit në zbatim të ligjit për buxhetin e vitit 2015. Paravsisht kësaj nga KQ Gjirokastrë janë bërë përpjekje që në rastet kur vendimet janë dhënë në favor të ish-nëpunësve civil për rikthimin e tyre, në një kohë që administrata duhet të jetë vetëm me **10** punonjës administrative, duke ezauruar të gjitha shkallët e gjyqësorit madje duke kërkuar edhe pezullimin e tyre në Gjykatën e Lartë.

- Në lidhje me masat që KQ Gjirokastrë ka marrë për largimet nga puna të punonjësve, janë zbatuar me përpikmëri të gjitha dispozitave ligjore për të shmangur efektet financiare që mund të rrjedhin prej tyre (Bashkëngjitur procesverbali i mbledhjes së KQ Gjirokastrë datë 14.05.2020, në të cilën është diskutuar edhe për këtë rekomandim).

Statusi: Zbatuar

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se nga ana e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë janë bërë përpjekje për të punësuar personelin e nevojshëm për Qendrën Terapeutike të fëmijëve me autizëm apo sindromën down, por me gjithë njoftimet e vazhdueshme për vende të lira pune, nuk gjenden persona me kualifikimin minimal të domosdoshëm. Rrjedhimisht, për shkak të këtyre mungesave, nga ana e Këshillit i Qarkut Gjirokastrë nuk është kryer plotësisht detyra e tij për t'i ardhur në ndihmë kësaj pjese të shoqërisë, e cila e ka domosdoshmëri jetike shërbimin e vazhdueshëm *(Më hollësisht trajtuar në pikën III, faqe 22, të Raportit të Auditimit, dhe aneks III)*.

3.1 Rekomandimi:

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të planifikojë nevojat për punonjës apo punësimin e personelit me kualifikime të përafërta apo qoftë edhe punësimin e personave të jashtëm, ekspertë dhe të kualifikuar në mënyrën e duhur, me qëllim ardhjen në ndihmë të fëmijëve të prekur nga autizmi.

Nga auditimi konstatohet se:

Këshilli Qarkut Gjirokastrë, duke marrë parasysh edhe numrin në rritje të fëmijëve që marrin trajtim pranë kësaj qendre, në kërkesën drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është kërkuar shtimi i numrit të specialistëve që ofrojnë shërbim pranë

kësaj qendre. Me shkresën nr. 630/2 prot. datë 03.02.2021 nga MSHMS është miratuar fondi për **14** punonjës që do të ofrojnë shërbim pranë Qendrës Terapeutike të Zhvillimit të Fëmijëve. Struktura e re e miratuar për vitin 2021 ka planifikuar një rritje të numrit të personelit me specialitete si logopedë, sociologë, psikologë dhe fizioterapistë. Po ashtu vetë Këshilli i Qarkut në vitin 2021 i ka ardhur në ndihmë kësaj kategorie të fëmijëve me ambiente të reja nëpërmjet investimit që ka kryer në një objekt të vënë në dispozicion nga Bashkia Gjirokastrë dhe në marrëveshje me këtë të fundit.

Statusi: Zbatuar

4- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë nuk është bërë shitja në ankand për skrap e disa aktiveve të dala jashtë përdorimi, duke i mbajtur gjendje në magazinë, gjë e cila rrjedhimisht kërkon kosto ruajtjeje dhe shkakton amortizimin e mëtejshëm dhe uljen e vlerës së këtyre aktiveve. Gjithashtu, edhe pajisjet dhe orenditë prej druri të dala jashtë përdorimit, pas vlerësimit duhet të shiten në ankand ose të përdoren për djegie nga institucioni. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 104 deri 120 (Më hollësisht trajtuar në pikën III faqe 23, të Raportit të Auditimit, dhe aneks III).

4.1. Rekomandimi:

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, të marrë masa që komisionet e vlerësimit të Aseteve, pasi të përpilojnë relacionet dhe procesverbalet përkatëse, të përfundojnë procedurat e asgjësimit ose përdorimit nga njësitë e tjera apo shitjes për materiale të këtyre aktiveve.

Nga auditimi konstatohet se:

Nga auditimi i dosjes, rezulton se nga ana e KQ Gjirokastrës janë ndjekur të gjitha procedurat e asgjësimit të materialeve në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 104 deri 120, duke asgjësuar të gjitha materialet e nxjerra jashtë përdorimit nga komisionet përkatëse dhe nga ana tjetër.

Në lidhje me mjetin Autoveturë "Mercedes Benz", Modeli E320 "CDI AVANTGARDE 4DR", është në proces për shitjen në ankand të mjetit, ka publikuar 8 herë njoftimin për shitjen në ankand të këtij mjeti.

Statusi: Zbatuar

5- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave dytësore që realizon Këshilli i Qarkut bazuar në legjislationin në fuqi, u konstatua se ka një sasi të konsiderueshme të ardhura të pa arkëtuara nga bashkitë, në formën e kuotave të anëtarësisë, të cilat janë miratuar nga këshillat e tyre përkatëse në vlerën **7,417,400 lekë**, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

Konkretisht, detyrimet janë: Bashkia Gjirokastrë për 3,000,000 lekë; Bashkia Libohovë për 828,400 lekë; Bashkia Dropull për 153,000 lekë; Bashkia Tepelenë për 815,000 lekë; Bashkia Memaliaj për 1,168,000 lekë; Bashkia Përmet për 600,000 lekë dhe Bashkia Këlcyrë për vlerën 900,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën III faqe 24-25, të Raportit të Auditimit, dhe aneks III).

5.1. Rekomandimi:

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, të marrë masa për të mbledhur kuotat nga bashkitë përbërëse të qarkut, duke përdorur të gjitha mënyrat e mundshme, përfshirë edhe procedurat gjyqësore.

Nga auditimi konstatohet se:

Këshilli i Qarkut ka marrë në analizë këtë pikë dhe në përfundim të shqyrtimit të saj (këshilltarët në statusin edhe të kryetarëve të njësive të veta bashkiake), kanë pranuar detyrimet që kanë ndaj Këshillit të Qarkut Gjirokastrë. Në kushtet aktuale në të cilat ndodhen pothuajse të gjitha bashkitë kanë probleme madhore në arkëtimin e të ardhurave të tyre dhe i kanë realizuar ato në një masë tepër të ulët nga parashikimi. Për këtë arsye këshilltarët kërkuar marrjen në konsideratë të kushteve të reja me të cilat po ballafaqohen

në situatën e pandemisë dhe kërkuar tolerancë në arkëtimin e këtyre të ardhura dhe detyrimeve të prapambetura për këtë vit buxhetor, ndërkohë që angazhohen për përmbushjen e këtyre detyrimeve por pa ndërmarrë masa shtrënguese sikurse janë procedurat ligjore të sugjeruara nga ana e KLSH-së.

Bashkëngjitur shkresat dërguar të shtatë njësisve vendore "Për përmbushjen e kontributit të detyrueshëm financiar për vitet e kaluara" e më konkretisht: nr. 347 Prot. datë 19.02.2020; nr. 347/1 Pro. datë 19.02.2020; nr. 347/2 Prot. datë 19.02.2020; nr. 347/3 Prot. datë 19.02.2020; nr. 347/4 Prot. datë 19.02.2020; nr. 347/5 Prot. datë 19.02.2020; nr. 347/6 Prot. datë 19.02.2020; nr. 580 Prot. datë 29.09.2020; nr. 757 Prot. datë 04.12.2020.

Statusi: Pa zbatuar

6- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se IMT nuk ka në përbërjen e saj K/Inspektor dhe inspektorë përkatës, pasi ky sektor është shkëputur dhe administrohet prej specialistëve të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, bazuar në Urdhrin nr. 14, datë 18.04.2016 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, pa marrë miratimin e Ministrisë së Bujqësisë, veprim në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr.9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore" (Më hollësisht trajtuar në pikën V faqe 30-32, të Raportit të Auditimit, dhe aneks V).

6.1. Rekomandimi:

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, të marrë masa për rishikimin e strukturës së Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës me qëllim ringritjen e Inspektoratit të Mbrojtjes së Tokës së Qarkut Gjirokastrë, duke marrë në konsideratë disponibilitetin prej tij të sipërfaqes së tokës prej 188,442 ha, nga e cila sipërfaqja prej 45,111 ha është tokë bujqësore.

Nga auditimi konstatohet se:

Kryetari i Këshillit të Qarkut në funksion të këtij rekomandimi ka lëshuar Urdhrin nr. 54 datë 18.06.2020 ku i ka ngarkuar kryerjen e detyrave funksionale të IMT-së tre punonjësve të DAMT. Kjo është një zgjidhje alternative për sa kohë është e pamundur në kushtet e strukturës së kufizuar me 10 punonjës të KQ për të pasur një strukturë të dedikuar për IMT-në. Kjo strukturë ka funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", VKM nr. 80 datë 25.01.2005 "Për përbërjen dhe mënyrat e funksionimit detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore". Për më tepër:

Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës në qark ka kryer:

- Kontrolle mbi dëmtimin dhe zaptimin e rrugëve të kalimit ne parcelat e tokave bujqësore, bankinave, kanaleve të III –ta, burmave të argjinaturave dhe vete argjinaturave.
- Kontrolle të përdorimit të tokës bujqësore për zhvillimet urbane (nuk ka asnjë ndërtim pa leje mbi tokën bujqësore).
- Kontrolle të raporteve teknike mbi dëmtimin e tokave bujqësore nga faktorë të ndryshëm natyrorë dhe njerëzorë si dhe masat që duhen marrë për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara.
- Janë kryer kontrole sipas procesverbaleve: në vitin 2017 janë mbajtur 7 (shtatë) procesverbale; në vitin 2018 janë mbajtur 7 (shtatë) procesverbale; në vitin 2019 janë mbajtur 11 (njëmbëdhjete) procesverbale.
- Materialet e kontrollit janë analizuar nga KMT në qark, i janë përcjelle rregullisht dhe bashkive përkatëse ku janë evidentuar dëmtimet.
- Kontrolle mbi administrimin e të ardhurave nga toka bujqësore për 40% sipas ligjit.
- Në raportimin periodik në ISHMT sipas formularit Nr. 5 Për evidentimin e përdorimit të fondit të tokës janë pasqyruar të dhënat për shumën e përdorur nga të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore. (bashkëngjitur formular 5).

Statusi: Zbatuar

7- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se mungojnë informacionet ligjore që njësitë vendore duhet të japin Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT-¹⁵) në fund të çdo viti, si kopje të kontratave të lidhura dhe zbatimin e projekteve. Gjithashtu mungojnë pagesat për këto toka të marra me qira pasi njësitë vendore nuk i kanë vënë në dispozicion këto të dhëna DAMT-¹⁶, në kundërshtim me Ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” dhe VKM Nr. 531 datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, ndryshuar me VKM Nr. 176 datë 30.03.2001.

Nga ana e DAMT nuk është kontrolluar dhe monitoruar zbatimin e plan bizneseve, për të cilën është dhënë toka bujqësore me qira.

Për sa i përket ecurisë lidhur me plotësimin e regjistrit të tokës rezulton se nuk ka bashkëpunim të vazhdueshëm midis njërive vendore dhe Qarkut Gjirokastër (Më hollësisht trajtuar në pikën V, faqe 32, të Raportit të Auditimit, dhe aneks V).

7.1. Rekomandimi:

Këshilli i Qarkut Gjirokastër dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të marrë masa dhe të kontrollojë dhe monitorojë vazhdimisht zbatimin e plan bizneseve për të cilën është dhënë toka bujqësore me qira, si dhe të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me njësitë vendore të Qarkut Gjirokastër.

Nga auditimi konstatohet se:

Sipas informacionit të KQ Gjirokastër, sqarohet se KLSH-së i është vënë në dispozicion informacioni për tokat me qira për çdo njësi vendore, si vijon:

Për sipërfaqet e tokave të dhëna me qira nga njësitë vendore, tokat e pandara dhe me qira nga Njësitë e Qeverisjes Vendore me orgjinë nga ish – kooperativa bujqësore që administrohen nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, sipas ligjit nr. 8312/1998, VKM nr. 531/1998 “Për tokat bujqësore të pandara” janë si më poshtë:

Nr.	Bashkia	Njësia Administrative	Sipërfaqja
1	Gjrokastër	Cepo	38.4
2	Gjrokastër	Lunxhëri	75.3
3	Gjrokastër	Antigone	16.9
4	Gjrokastër	Ödnie	3.9
5	Gjrokastër Antigone	Picar	3.4
6		Shuma	167.9
7	Libohovë	Zagorie	40
8		Shuma	40
9	Përmet	Petran	5.8
10	Përmet	Carçove	14
11	Përmet	Piskovë	23
12		Shuma	42.8
13	Këlcyrë	Dishnic	6.79
14	Këlcyrë	Ballaban	5.3
15		Shuma	13
16	Memaliaj	F-Memaliaj	10.61
17	Memaliaj	Buz	38.15
18	Memaliaj	Luftinje	26.84
19	Memaliaj	Qesarat	103.5
20	Memaliaj	Krahës	50.83
21		shuma	220
22	Tepelenë	Qendër	25
23	Tepelenë	Kurvelesh	7
24	Tepelenë	Lopë	8
25		Shuma	40
26	QARKU	Shuma	526

- Për sipërfaqet e tokave bujqësore në administrim të MBZHR në të dhëna me qira nga Drejtoria e Bujqësisë sipas VKM nr. 45/2014 të cilat janë si më poshtë:

Njësia Administrative Lunxhëri, Bashkia Gjirokastrë për sipërfaqen 31.4 ha (DRBU Gjirokastrë)

Njësia Administrative Lunxhëri Bashkia Gjirokastrë për sipërfaqen 71.7 ha (MBZHR)

Njësia Administrative Piskove, Bashkia Përmet për sipërfaqen 91 ha dhënë me qira nga MBZHR

Ndërsa vetë Qarku Gjirokastrë nuk ka në administrim Asete (tokë bujqësore) për dhënie me qira, kjo referuar nenit 2 e 11 të ligjit nr. 8752/2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës" të ndryshuar, DAMT administron ato Asete që i jepen me ligj.

Sa i takon gjetjes për regjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve në forme manuale dhe të dixhitalizuar sqarojmë:

Në zbatim të Urdhrit të Përbashkët nr. 107, datë 27/03/2009 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Brendshme "Për miratimin e përbajtjes të të dhënave të Regjistrit të tokës bujqësore dhe disa kategorive të tjera të resurseve", Qarku Gjirokastrë ka 270 ZK (zona kadastrale) Gjirokastrë 95 ZK, Tepelene 78 ZK, Përmet 97 ZK.

Kane kaluar në sistemin e regjistrimit fillestar (azhurnuar):

Gjirokastra ka përfunduar regjistrimi në të gjitha ZK, Tepelena ka pa regjistrim fillestar vetëm 2 (dy) ZK, Përmeti ka pa regjistrim fillestar 51 ZK.

Plotësimi i regjistrit të tokës bujqësore është ndikuar nga:

- VKM nr. 121/2011 "Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga DAMT -ja dhe ZAMT -të në komuna/bashki" pika 3, ku thuhet se:

"DAMT -ja në Këshillin e Qarkut për plotësimin e regjistrit të tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve i ofron ZAMT -se në komune dhe /ose bashki kopje të dokumentacionit që disponon dhe kontrollon ecurinë e plotësimit të këtij regjistri nga ZAMT -ja".

Në këtë rast DAMT-ja ka vënë në dispozicion të Njësive vendore librin e tokës dhe çdo dokumentacion tjetër. Njëkohësisht dhe nga Urdhri nr. 107 i sipërcituar, plotësimi i regjistrit të tokës bëhet nga ZAMT në komuna/ bashki, për të cilat duhet thënë se shume pak janë të azhurnuara dhe sipas tabelave me tepër janë plotësuar nga specialistet e drejtorisë.

Ecuria e plotësimit të tokës është penguar për më tepër sepse Regjistrimi fillestar nga Projekti është bërë me shume gabime ku ka mospërputhje dhe ndryshim të numërimit nga librat e ngastrave dhe hartat kadastrale si dhe me formularët nr. 6 dhe të dhënat sipas AMTP -ve (Ecuria e regjistrit të tokës është trajtuar në çdo mbledhje të KMT në qark).

Me i detajuar ky informacion jepet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia Gjirokastrë	Zk 38	Plotësuar manuale 10	Dixhitale 7
Bashkia Libohovë	16	5	-
Bashkia Dropull	41	20	20
Bashkia Përmet	48	10	10
Bashkia Këlcyrë	49	-	-
Bashkia Tepelene	27	7	-
Bashkia Memaliaj	51	37	37
Totali	270	79	64

Nga DAMT, sipas informacionit datë 14.12.2020 është ushtruar kontroll në Njësitë Vendore të Qarkut Gjirokastrë në lidhje me kontratat e qirave për të cilat janë evidentuar dhe problematikat të cilat i janë relatuar Komisionit të Mbrojtës së Tokës për vendimmarrje, kjo në zbatim të planeve të punës dhe ligjit nr. 139-2015 Për Vetëqeverisjen Vendore; ligji nr. 9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e Tokës bujqësore" i ndryshuar;

VKM nr. 80, datë 28.01.2005 "Për përbërjen dhe mënyrat e funksionit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës, si dhe rekomandimit të KLSH, konkretisht është evidentuar se:

- a- Për tokat bujqësore të pa mbjella për të cilat kontrata nuk është e noterizuar të anulohen kontratat.
- b- Për tokat bujqësore të pa mbjella për të cilat kontrata është e noterizuar të ndiqet rruga ligjore për prishjen e kontratës.
- c- Për bashkinë Memaliaj e cila ka numrin dhe sipërfaqen e tokave të dhëna me qira shumë të lartë të verifikohen së pari ato subjekte qiramarrëse që kanë mbivendosje me Vendimet 770/2014 dhe 45/2014.
- d- Meqenëse volumi i punës ishte tepër i madh si dhe kushtet e Covid-19 për bashkitë ku informacioni ka qenë jo i plotë me përgjegjësi do të verifikohet ecuria e projektit dhe investimit për të cilën është lidhur kontrata.
- e- Kontratat të cilat kanë mbivendosje me V.K.M Nr. 770/2014 "Për sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara të cilat janë në fondin e kompensimit fizik të ATP", VKM 45/2014 "Për sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara të cilat janë në administrim të MBZHR", por janë lidhur para daljes së këtyre Vendimeve (kryesisht në vitin 2013) të verifikohen me përparësi dhe të informohen institucionet përkatëse.
- f- Për tokat bujqësore të zaptuara në pronësi shtet dhe në administrim të bashkive sipas V.K.M – së Nr. 531/1998 IMT bashki/ qark ti evidentojnë ato rast pas rasti.

Statusi: Zbatuar

8- Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP), pranë Prefekturës Gjirokastrë, me Vendimin nr. 76, datë 15.06.2010, ka shfuqizuar pjesërisht AMTP nr. 4330, dhe kthimin e sipërfaqes prej 2980 m² në pronësi "shtet", përfituar më tepër në kundërshtim me ligjin, në emër të z. *Aleks Vangjel Buka*, fshati Jorgucat, komuna Dropull i Sipërm. Vendimi i mësipërm i KVVTP Gjirokastrë për sipërfaqen prej 2980 m², ka marrë formë të prerë sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr. 5535, datë 26.12.2017, që ka vendosur të deklarojë pavlefshmëri të pjesshme të AMTP-së dhe kthimin në pronësi "shtet" të sipërfaqes prej 2980 m². DAMT Qarku Gjirokastrë duhet të kishte marrë në dorëzim tokën e lirë nga KVVTP, pasi kjo tokë do të përdoret për kompensimin e ish-pronarëve. Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenet 3 dhe 11 të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe Mbrojtjen e tokës", të ndryshuar dhe nenin 10, të Ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën V, faqe 32 - 33, të Raportit të Auditimit, dhe aneks V*).

8.1. Rekomandimi:

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Qarkut Gjirokastrë, të marrë masa për marrjen në dorëzim të sipërfaqes prej 2980 m², për 1 rast të kthyer "shtet" nga pavlefshmëria e pjesshme e vendimit të KVVTP pranë Prefekturës Gjirokastrë dhe vendimit gjyqësor të formës së prerë për kthimin shtet të kësaj sipërfaqeje.

Nga auditimi konstatohet se:

Sipas informacionit të paraqitur nga KQ Gjirokastrë, në këtë gjetje argumenti nuk qëndron sepse në informacionin e dhënë KLSH-së, Vendimet e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve (KVVTP) të pronësisë mbi tokën bujqësore pranë Prefekturës të Qarkut Gjirokastrë për vitet 2017 dhe 2018, nuk ka praktika të marrjes së tokës në dorëzim sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Për vitin 2019 kemi vetëm një praktikë për deklarim të pjesshme të AMTP, nr. 4330 fshati Jorgucat, sipas Vendimit nr. 76, datë 15/6/2010 të KVVTP dhe Vendimit nr. 5535, datë 26/12/2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Sipas VKM nr. 531/1998 "Për tokat bujqësore të pandara" pika 1 citohet:

Sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara që janë në administrim të Drejtorive të Përgjithshme të Pyjeve e Kullotave, dhënë me ligjin 8047 datë 14.12.1995 "Për administrimin e tokave të refuzuara" të kalojnë për administrim nga Këshillat e Kominave/Bashkive.

Për rastin në fjalë sipërfaqja prej 2980 m² ka statusin toke e pa ndare "shtet". Për rrjedhojë me shkresat nr. 530 /2, datë 26/8/2019, nr. 530/4, datë 09/09/2019, KQ Gjirokastrë sipas procesverbalit nr. 1 dt. 26/7/2019 të KVVTP, i ka përcjellë për veprim Bashkisë Dropull, e cila është përgjegjëse për administrimin e kësaj sipërfaqe toke si dhe ASHK Gjirokastrë për ndryshim të statusit juridik.

Statusi: Zbatuar

9- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit, rezultoi se në një rast, procedura me objekt: "Rikonstruksion i varrezave të dëshmorëve, Gjirokastrë", të zhvilluar në vitin 2017, me fond limit 9,625 mijë lekë, disa nga kriteret për kualifikim nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si kërkesat për certifikata ISO, mjek, restaurator në stafin teknik të shoqërisë, arkitekt etj., veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën IV, faqe 27 -30, të Raportit të Auditimit, dhe aneks IV).

9.1. Rekomandimi:

Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në përcaktimin e kriterëve për kualifikim të ketë në konsideratë objektin e prokurimit dhe të përputhë këto kriterë me të.

Nga auditimi konstatohet se:

Këshilli i Qarkut ka marrë masa që në procedurat e tjera kriteret të aplikohen në përputhje me procedurën e prokurimit.

Statusi: Zbatuar

10- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ri kërkimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në janar 2018, është ri kërkuar shpërblimi i dëmit në shumën **5,231,856 vlerën lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera prej 5,231,856 lekë është arkëtuar vlera prej 125,667 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej 5,106,349 leke, e cila është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 – "Debitorë të Pasqyrave Financiare" më datën 31.12.2016.

Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit deri më datën 15.01.2020:

Janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë, janë kontabilizuar dhe janë arkëtuar në 8 raste vlera 125.667 lekë; Nuk janë pranuar, nuk janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe nuk janë kontabilizuar vlera 199.500 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 17 -18, të Raportit të Auditimit, dhe aneks I).

10.1 Rekomandimi:

Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, të merren masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij. Të njoftohet KLSH për masat e marra.

Nga auditimi konstatohet se:

Përsa i takon detyrimin për tu arkëtuar nga Subjekti "Eral Construction" në vlerën 4,554,052 lekë (që përbën pjesën kryesore të detyrimit të mbetur pa arkëtuar), çështja është në proces gjyqësor dhe së fundmi është rikthyer për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, pas ankimit të bërë nga ana jonë. Bashkëngjitur Njoftimi për zhvillimin e seancës pranë kësaj gjykate.

Përsa i takon ekzekutimit të detyrimit që ish punonjësi "Beqir Liti" ka ndaj KQ Gjirokastrë, është detyrim në proces ekzekutimi. I është dërguar titulli ekzekutiv përmbaruesit gjyqësor

privat "Bujar Shehu" për ekzekutim (Bashkëngjitur përgjigja nr. 185 prot. datë 16.02.2021 e përmbaruesit gjyqësor Bujar Shehu).

Kronologjia: Me Vendim të Gjykatës së Shkallës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër nr. 647, datë 06.11.2017, ku është vendosur rrëzimi i padisë duke dhënë të drejtë subjekti. Nga KQ Gjirokastër ankimuar çështja në Gjykatën e Apelit Tiranë ku me Vendim nr. 846, datë 01.10.2020, çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastër, sipas Njoftimit nr. 549/82, datë 16.02.2021.

Statusi: Në proces

B. MASA DISPLINORE:

Mbështetur në Nenin 58 "Llojet e masave disiplinore" shkronja (c), të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe nenin 64 shkronjat (g) dhe (k) të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i rekomandojmë Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastër, që t'i kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, "Vërejtje", për 1 punonjës.

1- Bekim Sinani, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Gjirokastër, pasi:

Mungojnë informacionet ligjore që njësitë vendore duhet të japin në DAMT në fund të çdo viti, si kopje të kontratave të lidhura dhe zbatimin e projekteve. Mungojnë pagesat për këto toka të marra me qira pasi njësitë vendore nuk i kanë vënë në dispozicion këto të dhëna DAMT-¹.

Nga ana e DAMT nuk është kontrolluar dhe monitoruar zbatimi i plan bizneseve për të cilën është dhënë toka bujqësore me qira.

Përsa i përket ndërtimeve të paligjshme, nuk janë kryer kontrole.

Përsa i përket ecurisë lidhur me plotësimin e regjistrit të tokës rezulton se nuk ka bashkëpunim të vazhdueshëm midis njërive vendore dhe Qarkut Gjirokastër.

Nga auditimi konstatohet se:

Nga ana e Kryetarit të KQ Gjirokastër ka dalë Urdhri i Kryetarit nr. 5 datë 06.01.2020 "Për ngritjen e Komisionit Disiplinor" i ndryshuar, si dhe Vendimi nr. 1 datë 22.06.2020 i Komisionit Disiplinor. Shqyrtimi i këtij rasti i është deleguar komisionit disiplinor te institucionit, i cili me Vendimin nr. 359 prot, datë 22.06.2020 ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore për nëpunësin "Bekim Sinani", bashkëngjitur vendimi.

Statusi: Zbatuar

C- MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor, **3 punonjësve** si më poshtë:

1. **Jonida Fejzulla** – Jurist- punonjës i jashtëm, në cilësinë e anëtarit të NJHDT;
2. **Lorenc Bami** – inxhinier ndërtimi, punonjës i jashtëm, në cilësinë e anëtarit të NJHDT;
3. **Ylli Alika** - me detyrë Drejtor i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, në cilësinë e anëtarit të NJHDT;

Pasi në tenderin me objekt "Rikonstruksion i varrezave të dëshmorëve, Gjirokastrë", me urdhër prokurimi nr.3, datë 23.05.2017, me fond limit 9,625,591, lekë, nga auditimi i kërkesave për kualifikim, u konstatuan kërkesa në kundërshtim me LPP dhe akte të tjera ligjore që nuk kanë lidhje me procedurën e prokurimit si kërkesat për:

Certifikata ISO si: Certifikatë ISO 27001:2013 Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë së informacionit", Certifikatë ISO 50001:2011, "Për sistemin e menaxhimit të energjisë" dhe Certifikatë EN ISO3834-2:2006, "Për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit",

- Mos argumentim i numrit të punonjësve;
- Në lidhje me drejtuesin teknik;
- Kërkesa për restaurator në stafin drejtues teknike, etj.

Nga auditimi konstatohet se:

Me shkresën nr. 2637-6 prot, datë 24.06.2020, APP-ja ka dërguar pranë KQ Gjirokastrë Vendimin nr. 24, datë 24.06.2020 "Shqyrtim Raport Auditimi", mbi shkëlqet e konstatuara nga KLSH-ja në procedurën me objekt: "Rikonstruksion i varrezave të dëshmorëve, Gjirokastrë", të zhvilluar në vitin 2017, me fond limit 9,625 mijë lekë.

Sipas vendimit të APP, personat përgjegjës janë paralizuar me gjobë në vlerën 120,000 lekë, konkretisht punonjësit (anëtarë të NJP); z. **Ylli Alika** në masën **40,000 lekë**, zj. **Jonida Fejzulla** në masën **40,000 lekë** dhe z. **Lorenc Bami** në masën **40,000 lekë**. Nga dega e financës është bërë njoftimi i punonjësve dhe kontabilizimi i gjobës sipas vendimit të APP. Nga anëtari z. **Ylli Alika** është bërë likuidimi i gjobës në masën 40,000 lekë me datë 14.10.2020 (faturë për arkëtim).

Ndërsa dy anëtarët e tjerë zj. **Jonida Fejzulla** dhe z. **Lorenc Bami** kanë ankimuar gjobën e vënë në Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë (Bashkëngjitur ekstrakti i arkëtimit, nxjerrë nga Dega Rajonale Gjirokastrë për anëtarin **Ylli Alika** dhe Njoftimi i Gjykatës Adm të Shkallë së parë Tiranë për zhvillimin e seancës përgatitore të çështjes me objekt "Kundërshtimin e gjobës" së vendosur nga APP për dy anëtarët e tjetër. Sipas njoftimit nr. 3529, datë 08.01.2021 i Gjykatës Administrative Shkallës së Parë Tiranë. Në proces gjykimi.

Statusi: Zbatuar

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi tematik mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe manualit për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve së KLSH-së, i kryer në Këshillin e Qarkut Gjirokastrë për periudhën 11.02.2021 deri me 26.02.2021 dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve (në numër), plotësisht ose proces zbatimi është 92.8 %.

Ndërsa e shprehur në vlerë, nga vlera e rekomanduar prej 12,769 mijë lekë, pranuar në masën 100% nga subjekti. Nga vlera e pranuar janë zbatuar, proces gjyqësor dhe në proces zbatimi vlera 5,352 mijë lekë ose 42 % dhe nuk është zbatuar vlera 7,417 mijë lekë ose 58 %.

Nga sa shikohet niveli i zbatimit të rekomandimeve është në nivelet 92.8 % si numër dhe 42 % si vlerë, gjë e cila tregon se Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka vlerësuar procesin e zbatimit të rekomandimeve, por duhet të përqendrohet akoma më shumë në arkëtimin e vlerave të paarkëtuara dhe të proceseve gjyqësore, kjo për të eliminuar kalimin e afateve ligjore të kërimit të vlerave, përcaktuar kjo në nenin 15, të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 të Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, nga Këshilli Qarkut Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 1047/5 datë 22.04.2020, duke qenë se pjesa më e madhe e tyre janë të zbatuara dhe kanë mbetur për zbatim vetëm dy prej tyre për të cilat do **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore për zbatim, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1- Gjetje nga auditimi (sipas pikës 5 të masave organizative): Nga auditimi i të ardhurave dytësore që realizon Këshilli i Qarkut bazuar në legjislacionin në fuqi, u konstatua se ka një sasi të konsiderueshme të ardhura të pa arkëtuara nga bashkitë, në formën e kuotave të anëtarësisë, të cilat janë miratuar nga këshillat e tyre përkatëse në vlerën **7,417,400 lekë**, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për Këshilli i Qarkut Gjirokastrë.

Konkretisht, detyrimet janë: Bashkia Gjirokastrë për 3,000,000 lekë; Bashkia Libohovë për 828,400 lekë; Bashkia Dropull për 153,000 lekë; Bashkia Tepelenë për 815,000 lekë; Bashkia Memaliaj për 1,168,000 lekë; Bashkia Përmet për 600,000 lekë dhe Bashkia Këlcyrë për vlerën 900,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën III faqe 24-25, të Raportit të Auditimit, dhe aneks III).

1.1. Rekomandimi:

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, të marrë masa për të mbledhur kuotat nga bashkitë përbërëse të qarkut, duke përdorur të gjitha mënyrat e mundshme, përfshirë edhe procedurat gjyqësore.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi (sipas pikës 12 të masave organizative): Nga auditimi i ri kërkimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në janar 2018, është ri kërkuar shpërblimi i dëmit në shumën **5,231,856 vlerën lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera prej 5,231,856 lekë është arkëtuar vlera prej 125,667 lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera prej 5,106,349 leke, e cila është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 – “Debitore të Pasqyrave Financiare” më datën 31.12.2016.

Nga verifikimi rezultoi se nga shuma e rekomanduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit deri më datën 15.01.2020, janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë, janë kontabilizuar dhe janë arkëtuar në 8 raste vlera 125,667 lekë; Nuk janë pranuar, nuk janë nxjerrë urdhrat ekzekutivë dhe nuk janë kontabilizuar vlera 199,500 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën I, faqe 17 -18, të Raportit të Auditimit, dhe aneks I).

2.1 Rekomandimi:

Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, të merren masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Për këtë të ndiqen të gjitha rrugët e mundshme ligjore deri në hapjen e proceseve gjyqësore. Nga titullari të hartohet një plan veprimi dhe të caktohen personat përgjegjës për zbatimin e tij. Të njoftohet KLSH për masat e marra.

Menjëherë

“Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi”.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

ANEKSE

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Aneksi 1

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithësej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit në %	Statusti i rekomandimeve të pranuar										
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Në proces gjyq				
									Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa organizative	10	12,649	10	12,649			100											
2	Masa disiplinore	1	0	1	0	0	0	100											
	- Nr. Statuti Niv. sipas Civil	1		1		0	0	100											
	- Nr. Kushtetut paas																		
3	Masa Administrative	3	120	3	120	0	0	100											
	- Nga APP	3	120	3	120			100											
	Nga të cilat pa konstatuar																		
	- Nga IMTV																		
	Nga të cilat pa konstatuar																		
11	Tyera																		
	TOTALI	14	12,769	14	12,769	0	0	100	10	40	3	0	0	0	0	1	7,417	2	5,311

PASQYRA E MASAVE ORGANIZATIVE

Aneksi 2

Rekomanduar	Pranuar		Zbatuar		Në proces zbatimi		Pa zbatuar		Proces Gjyqësor	
	NR	Vlerë	NR	Vlerë	NR	Vlerë	NR	Vlerë	NR	Vlerë
1	1		1							
1	1		1							
1	1		1							
1	1		1							
1	1		1							
1	7,417,400		1	7,417,400			1	7,417,400		
1	1		1							
1	1		1							
1	1		1							
1	1		1							

NR	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar		Në proces zbatimi			Pa zbatuar		Proces Gjyqësor	
	Vlerë	NR	Vlerë	NR	Vlerë	NR	Vlerë	Arketuar	Mbetja	NR	Vlerë	NR	Vlerë
1	5,231,856	1	5,231,856						0				
10	12,649,256	10	12,649,256	8	0	0	0	0	0	1	7,417,400	1	5,231,856